



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 565/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk, “AEK” shpk, “Flena RB” shpk si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “Azizolli” shpk dhe “Lybeshari” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-64628-04-24-2018 me objekt: *“Ruajtja e godinës së qendres polivalente për shërbimet e perklujdesit shoqëror Polican me roje private” – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 2.079.047.⁷⁶ lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 08.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Qendra Polivalente për Shërbime të Perkujdesit Shoqëror Polican.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Lybeshari” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Flena RB” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

“Nazeri 2000” shpk
Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kati II, Tiranë

“Lybeshari Security” shpk
Kushtrim, Berat

“Myrto Security” shpk
Lagjia “Kastriot”, Rruga “Brigada e 11 Sulmuese” godina e Albtelecom, Fier

“Flena RB” shpk
Rruga “Sulejman Pasha”, Pallati i ri 9 katësh, pranë Gjimnazit “Sinan Tafaj” Tiranë

“Myrto Security” shpk
Lagjia “Kastriot”, Rruga “Brigada e 11 Sulmuese” godina e Albtelecom, Fier

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Polivalente per Shërbime te Perkujdesit Shoqeror Polican
Polican

Subjekt i Interesuar:

“AEK Security” shpk
Ish Kombinati i Tekstileve Berat

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Vlerësimi paraprak


I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.



Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 24.04.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-64628-04-24-2018 me objekt: “Ruajtja e godinës së qendres polivalente për shërbimet e perklujdesit shoqëror Polican me roje private” – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 2.079.047.⁷⁶ lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 08.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Qendra Polivalente për Shërbime të Perklujdesit Shoqëror Polican

II.2. Në datën 08.05.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 11.05.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Azizolli" shpk	1,943,919.00	I skualifikuar
- Lybeshari	2,078,993.82	I skualifikuar
- AEK Security	2,079,047.61	I kualifikuar
- Flena RB	2,079,047.61	I kualifikuar
- Myrto Security	2,079,047.61	I kualifikuar

- Nazeri – 2000 2,079,047.61 I kualifikuar

II.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 17.05.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Azizolli" shpk 1,943,919.00 I skualifikuar
- Lybeshari 2,078,993.82 I skualifikuar
- AEK Security 2,079,047.61 I kualifikuar
- Flena RB 2,079,047.61 I kualifikuar
- Myrto Security 2,079,047.61 I skualifikuar
- Nazeri – 2000 2,079,047.61 I kualifikuar

III.5. Në datën 28.05.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku referuar vlerave të ofertave ekonomike, të hedhura nga autoriteti kontraktor në SPE, rezulton si më poshtë vijon:

- Azizolli shpk 1,943,919.00 I skualifikuar
- Lybeshari 2,078,993.82 I skualifikuar
- AEK Security 2,079,047.61 I kualifikuar
- Flena RB 2,079,047.61 I skualifikuar
- Myrto Security 2,079,047.61 I skualifikuar
- Nazeri – 2000 2,079,047.61 I kualifikuar

II.6. Në datën 15.05.2018 operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Së pari duhet të skualifikohet shoqëria Flena RB pasi nuk ka paraqitur 6 certifikata të vlefshme brenda afatit 4 vjecar sipas listës emërore të DVP dhe kërkesës në DST kapaciteti ligjor pika 3 dhe nuk ka AKEP Radiokomunikim dhe alarm për qytetin e policanit sipas DST-së.*
- *Së dyti duhet të skualifikohet Myrto Security shpk, AEK Security pasi nuk ka AKEP radikomunikim dhe alarm për qytetin e policanit sipas DST si dhe aktin e miratimit të Qendrës së Kontrollit DVP Berat është i pavlefshëm pasi është jashtë afatit 2 vjecar sipas udhëzimit nr.130 datë 05.03.2018 Kreu VII gërma D, pika 5.*
- *Si dhe të shtohen arsyet e skualifikimit për Azizolli dhe Lybeshari pasi nuk përmbushin detyrimet për pagë bazë , shtesa turni sigurime dhe oferta e tyre është nën koston ligjore*

II.7. Në datën 16.05.2018 me shkresën nr. 190/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me pranimin pjesërisht të ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor lidhur me pretendimin për aktin e miratimit të qendres së kontrollit për operatorin ekonomik Myrto Security shpk.

II.8. Në datën 24.05.2018, pala ankimuese “Nazeri 2000” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.9. Në datën 11.05.2018 operatori ekonomik “Lybeshari” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

Formulari i ofertes nuk ka bashkelidhur preventivin e koston per nje roje dhe 1 vend-roje me 2 turne(II,III) (3.32 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme.

Nr. Emërtimi

1 Shpenzime për pagë bazë

2 Shtesë mbi pagë për turnin II

3 Shtesë mbi pagë për turnin III

4 Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%

II.10. Në datën 18.05.2018 operatori ekonomik “Lybeshari” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

- *E vetmja gje e cila i mungon analizës janë vijat e tabelës. Pra të bindur se ne kemi llogaritur të gjithë komponentët ligjore të ofertës që ju kërkoni në DST kërkojmë kualifikimin e operatorit Lybeshari Security.*

II.11. Në datën 21.05.2018, me shkresën nr.199 prot, operatori ekonomik “Lybeshari Security” shpk., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.12. Në datën 29.05.2018 pala ankimuese “Lybeshari Security” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.13. Në datën 17.05.2018 operatori ekonomik “Myrto Security” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Nuk ka paraqitur Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit miratuar nga Policia e Qarkut Berat brenda afatit 2 vjecar.*

II.14. Në datën 22.05.2018 operatori ekonomik “Myrto Security” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

- *Vlerësimi i datës 17.05.2018 për refuzimin/skualifikimin e ofertës sonë është absolutisht i gabuar. Në shtojcën 7 Kapaciteti teknik pika 2 e DT është përcaktuar: Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF si dhe Dokumenti i Performances mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit te operatorit ekonomik. Per kete duhet te paraqese **vertetim nga Drejtoria e Policise se Qarkut** ku jepet informacioni i mesiperem i kerkuar. Në përmbushje të këtij kriteri kemi paraqitur: Akt Miratimin (për Qendrën e Kontrollit) nr.1104 prot datë 18.09.2015 lëshuar nga Drejtoria*

Vendore e Policisë Berat. Vërtetim nr.520/1 prot datë 23.02.2018 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat. Nëpërmjet këtyre dy akteve provohet plotësisht se Myrto Security shpk ka në funksion Qendër Kontrolli të miratuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat me adresë Lagjja 30 Vjetori pranë DVP Berat. Pra sipas kërkesës në kriterin e sipërcituar kemi provuar plotësisht ekzistencën e Qendrës së Kontrollit duke paraqitur aktet e kërkuesit si provë. Në momentin e miratimit të qendrës së kontrollit dhe lëshimit të aktit të miratimit (Shtator 2015) legjislacioni në fuqi i sipërcituar parashikonte që akti i miratimit lëshohej pa afat. Konstatimi i pavlefshëmisë së akteve duke ju referuar Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 është i gabuar pasi nga KVO i është dhënë fuqi prapavepruese kësaj dispozite pra Aktin e Miratimit nr.1104 prot datë 18.09.2015 që është lëshuar për një afat të pacaktuar (pa afat) i është dhënë afat 2 vjecar. Ju sjellim në vëmendje se norma juridike nuk mund të zbatohet para se të jetë krijuar sepse ajo krijohet për tu zbatuar për situata të cilat do të ndodhin pasi të jenë krijuar normat. Për rrjedhojë afati 2 vjecar i aktit të miratimit datë 18.09.2015 i fillon prej datës 09.03.2018 kur Udhëzimi i ri ka hyrë në fuqi. Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.

II.15. Në datën 24.05.2018, me shkresën nr.200/1 prot, operatori ekonomik “Myrto Security” shpk., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.16. Në datën 01.06.2018 pala ankimuese “Myrto Security” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.17. Në datën 28.05.2018 operatori ekonomik “Flena RB” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Shoqëria Flena RB skualifikohet sepse nuk plotëson kriterin e vecante teknik AKEP radiokomunikimi dhe alarm për qytetin e Policanit sipas DST, pas ka vetem AKEP radiokomunikimi dhe alarm për qytetin Berat, Skrapar, Kucove, Ura Vajguore . Skualifikimi behet pas paraqitjes se ankeses prane AK dhe referuar vendimit te KPP nr.774 /2016 dt 6.10.2016.*

II.18. Në datën 01.06.2018 operatori ekonomik “Flena RB” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

- *Vlerësojmë se vendimi i datës 28.05.2018 nuk është i drejtë. Në shtojcën 7 Kapaciteti Teknik pika 4 e DT është përcaktuar: 4. Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi qytetin e Policanit . Në përmbushje të këtij kriteri kemi paraqitur Autorizim Individual nr.919/1 datë 23.03.2018 lëshuar nga AKEP. Sipas këtij autorizimi jemi licensuar për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm me zonë mbulimi Berat, Skrapar, Kucovë Urë Vajguore 40 km. Zona e mbulimit mbulon teorikisht dhe praktikisht gjithë zonën për të cilën jemi licensuar. Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e Flena RB shpk.*

II.19. Në datën 05.06.2018, me shkresën nr.222 prot, operatori ekonomik “Flena RB” shpk., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.20. Në datën 12.06.2018 pala ankimuese “Flena RB” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.21. Në datën 28.05.2018 operatori ekonomik “Myrto Security” shpk është rinjoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Ne zbatim te udhezimit nr.130 date 5.03.2018 kreu VII, paragrafi D pika 5 " Miratimi i Qendres së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet nga drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, bazuar në vendimin e KSHKC-së, në çdo dy vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në aktin e miratimit bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve." Akti i miratimit te qendres se kontollit eshte jashte afatit 2 vjecare sipas ketij udhezimi pasi eshte miratuar nga Policia e Qarkut Berat ku ushtron aktivitetin SHPSF me nr. 1104 prot date 18.9.2015 .*
- *Gjithashtu Shoqeria skualifikohet sepse nuk ploteson kriterin e vecante teknik AKEP radiokomunikimi dhe alarm per qytetin e Policanit sipas DST, pas ka vetem AKEP radiokomunikimi dhe alarm per qytetin Berat, Skrapar, Kucov, Ura Vajgurore . Skualifikimi behet pas paraqitjes se ankeses prane AK dhe referuar vendimit te KPP nr.774 /2016 dt 6.10.2016.*

II.22. Në datën 01.06.2018 operatori ekonomik “Myrto Security” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

- *Vlerësojmë se ashtu si vendimi i datës 17.05.2018 edhe vendimi i datës 28.05.2018 nuk është i drejtë. Në shtojcën 7 Kapaciteti Teknik pika 4 e DT është përcaktuar: 4. Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave per radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi qytetin e Policanit Në përmbushje të këtij kriteri kemi paraqitur Autorizim Individual nr.2115/1 datë 01.12.2017 lëshuar nga AKEP. Sipas këtij autorizimi jemi licensuar për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm me zonë mbulimi Berat, Skrapar, Kucovë Urë Vajgurore 40 km. Zona e mbulimit mbulon teorikisht dhe praktikisht gjithë zonën për të cilën jemi licensuar. Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e Myrto Security shpk.*

II.23. Në datën 05.06.2018, me shkresën nr.221 prot, operatori ekonomik “Myrto Security ” shpk., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.24. Në datën 13.06.2018 pala ankimuese “Myrto Security” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.25. Nëpërmjet shkresës nr.227 prot, datë 04.06.2018, prot me tonën me nr.993/2 prot datë 07.06.2018, nr.230/1 datë 07.06.2018 prot me tonën me nr.1039/2 datë 11.06.2018, nr.223/1 prot datë 06.06.2018 prot me tonën me nr.1013/2 datë 07.06.2018, nr.236/1 datë 19.06.2018 prot me

tonën me nr.1090/2 datë 22.06.2018, nr.237/1 datë 27.06.2018 prot me tonën me nr.1102/2 datë 28.06.2018 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Lybeshari” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Formulari i ofertes nuk ka bashkelidhur preventivin e kostos per nje roje dhe 1 vend-roje me 2 turne(II,III) (3.32 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Nr. Emërtimi

1 Shpenzime për pagë bazë

2 Shtesë mbi pagë për turnin II

3 Shtesë mbi pagë për turnin III

4 Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%”, si dhe pretendimit të Nazerit për lenien e skualifikuar të operatorit Lybeshari shpk si ofertë nën koston e lejuar ligjore”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si vijon:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;

2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendroje ve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	Sherbimi i ruajtjes se godines se Qendres Polivalente per sherbime te perkujdesit shoqeror Polican	(X)	(X)	(X)	(X)	(X)
	Oferta Neto ne total					
	TVSH (%)					(X)

	<i>Oferta total</i>	(X)
--	---------------------	------------

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

1. Ne çmim janë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor në lidhje me pagat, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për shërbimin e ruajtjes në një vend-roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit të çmimit të ofertes të paraqitet preventivi për një roje dhe **1 vend-roje me 2 turne(II,III) (3.32 roje) në muaj**, sipas tabelës së mëposhtme.

Nr.	Emërtimi
1	Shpenzime për pagë bazë
2	Shtesë mbi pagë për turnin II
3	Shtesë mbi pagë për turnin III
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%

Analiza e kostos

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 03.05.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vend-roje me dy turne të llogaritet **3.32 (Ore pune/punonjës/muaj: 174 ore)**. Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).

- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit).
- **Klasifikimi i ofertave behet mbi bazen e vleres se ofertes se dhene ne total.**

III.1.2. Në shtojcën 8 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" pika 2.3/7 "Kapaciteti Teknik" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- *Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin **analizen e kostos per oferten e paraqitur.** (Shih Shtojca 1 - Sqarime)*

III.1.3. Në shtojcën 11 "Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shërbimi që kërkohet: Objekti: "Ruajtja e godinës se qendres polivalente per shërbimet e perkujdesit shoqeror Polican me roje private" – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj. – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar)

Vendndodhja e shërbimit: Qendra Polivalente per shërbime te perkujdesit shoqeror Polican

<i>Numri i Vendrojeve</i>	<i>Numri i turneve</i>	<i>Numri i rojeve te nevojshme</i>	<i>Afati i levrimit</i>
<i>1</i>	<i>2(turni dyte dhe turni trete)</i>	<i>3.32</i>	<i>12 muaj Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.</i>

III.1.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konstatohet se operatori ekonomik Lybeshari shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formulari i ofertës ekonomike bashkëlidhur Analiza e Kostos për një roje në muaj.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ka kërkuar shprehimisht se të gjithë ofertuesit, do të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos mujore të kryerjes së shërbimit. Në ofertën e tyre ekonomike, duhet të parashikojnë të gjitha detyrimet ligjore për kryerjen e këtij shërbimi; pra më konkretisht ofertuesit duhet të përlllogarisin pagën bazë minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë

si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%. Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës së operatorit ekonomik “Lybeshari” shpk, nuk ka paraqitur analizen e kostos në përputhje me përcaktimet në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi pasi në DT është përcaktuar shprehimisht se *Bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vend-roje me 2 turne(II,III) (3.32 roje) në muaj*. Ndërsa operatori ekonomik ankimues ka bërë përlllogaritje të cilat nuk përputhen me përcaktimet në DST duke mos pasqyruar saktë analizën e kostos për 3.32 roje.

Akoma më tej lidhur me pretendimin e ankimuesit “Nazeri 2000” shpk për skualifikimin e operatorit ekonomik “Lybeshari” shpk si ofertë nën koston e lejuar ligjore nga përlllogaritjet e kryera rezulton se operatori ekonomik “Lybeshari” shpk ka ofertuar nën koston e lejuar ligjore. Sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik nuk ka plotësuar analizën e kostos në përputhje me përcaktimet e bëra nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe rezulton nën koston e lejuar ligjore.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik Lybeshari shpk nuk qëndron ndërsa pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Nuk ka paraqitur Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit miratuar nga Policia e Qarkut Berat brenda afatit 2 vjecar*” si dhe lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk dhe “AEK Security” shpk me argumentin se *aktin e miratimit të Qendrës së Kontrollit DVP Berat është i pavlefshëm pasi është jashtë afatit 2 vjecar sipas udhëzimit nr.130 datë 05.03.2018 Kreu VII gërma D, pika 5*”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF si dhe Dokumenti i Performances mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik*

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Myrto Security” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- AKT MIRATIMI Nr.1104 prot datë 18.09.2015 “Për Qendrën e Kontrollit” lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat, bashkëlidhur lista e dokumentacioneve dhe pajisjeve për Myrto Security shpk

- AKT MIRATIMI i Qendrës së Kontrollit Nr.415 prot datë 18.04.2018 për AEK Security shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat lëshuar në baë të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “c” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

III.2.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.2.5. Referuar korenspondences së mbajtuar nga KPP me Dejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit lidhur me këtë problematikë për një çështje të ngjashme (shkresa nr.4986/2 prot datë 04.07.2018) sqarohet se: *“Akt Miratimi Për Qendrën e Kontrollit nr.1104 datë 18.09.2015 lëshuar nga Drejtoria e Policisë Berat për subjektin Myrto Security është i vlefshëm në momentin e dorëzimit 10.04.2018 deri në miratimin e aktit të ri nga DVP Berat në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130 datë 05.03.2018. Aktet e miratimit për qendrat e kontrollit të shpsf-ve të miratuara në zbatim të Udhëzimeve të Ministrit të Brendshëm nr.157 datë 01.04.2015 dhe nr.308 datë 22.05.2017 kanë qenë pa afat. Këto akte do të konsiderohen të vlefshme deri në momentin e kryerjes së procedurave të miratimit apo refuzimit nga Drejtoritë Vendore të Policisë në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130 datë 05.03.2018. Afati i Miratimit të Qendrave të Kontrollit të shërbimeve në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130 datë 05.03.2018 është 2 vjet. ”.*

III.2.6. Referuar sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacion për qendrën e kontrollit të kërkuar në kriteret kualifikuese i cili rezulton i vlefshëm bazuar edhe në përgjigjen e organit kompetent Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. KPP gjykon se operatorët ekonomikë nuk mund të penalizohen për fakte të cilat janë jashtë kontrollit të tyre. Akt miratimi i lëshuar në vitin 2015 sikundër argumentohet në shkresën e sipërcituar është tërësisht i vlefshëm deri në momentin e pajisjes së operatorit ekonomik me aktin e ri sipas udhëzimit aktual në fuqi.

Gjithashtu AKT Miratimi i paraqitur nga operatori ekonomik “AEK Security” shpk është i vlefshëm pasi mban datën 18.04.2018 e rrjedhimisht është lëshuar mbi bazën e Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 i cili është aktualisht në fuqi

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk qëndron ndërsa pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Flena RB” shpk dhe “Myrto Security” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me pretendimin se *“Shoqeria skualifikohet sepse nuk ploteson kriterin e vecante teknik AKEP radiokomunikimi dhe alarm per qytetin e Policanit*

sipas DST, pas ka vetem AKEP radiokomunikimi dhe alarm per qytetin Berat, Skrapar, Kucov, Ura Vajgurore. Skualifikimi behet pas paraqitjes se ankeses prane AK dhe referuar vendimit te KPP nr.774 /2016 dt 6.10.2016”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Nga shqyrtimi i infomacionit të autoritetit kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në kthim përgjigjen drejtuar operatorit ekonomik ankimus “Nazeri 2000” shpk me datë 16.05.2018 me shkresën nr. 190/1 prot, ka vënë në dijeni ankimesin në lidhje me pranimin pjesërisht të ankesës, vetëm sa i takon pretendimit të tij për aktin e miratimit të qendres së kontrollit për operatorin ekonomik Myrto Security shpk. Ndërsa është vendosur mospranimi i ankesës për operatorët ekonomikë Flena RB shpk dhe AEK Security shpk.

Akoma më tek KPP konstaton se më datë 28.05.2018 autoriteti kontraktor ka marrë në rishqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik Nazeri 2000 dhe ka vendosur shtimin e arsyes së skualifikimit për operatorin ekonomik “Myrto Security” dhe skualifikimi i shoqërisë “Flena RB” me argumentin se *nuk plotesojnë kriterin e vecante teknik AKEP radiokomunikimi dhe alarm per qytetin e Policanit sipas DST, pas ka vetem AKEP radiokomunikimi dhe alarm per qytetin Berat, Skrapar, Kucov, Ura Vajgurore. Skualifikimi behet pas paraqitjes se ankeses prane AK dhe referuar vendimit te KPP nr.774 /2016 dt 6.10.2016.*

Në këto kushte KPP gjen me vend të tërheq vemendjen e autoritetit kontraktor për rivlerësimin e datës 28.05.2018 sa i takon skualifikimit të operatorit ekonomik Flena RB shpk dhe shtimit të arsyes së skualifikimit për operatorin ekonomik Myrto Security shpk pasi është kryer një kundërshtim me LPP.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (*Neni 9 i K.pr. Administrative*). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet se “*Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*” Në nenin 63 pika 3 e *lex specialis*, LPP parashikohet se “*Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.*” Gjithashtu në nenin 63 pika 6 e *lex specialis* i cili parashikon të drejtën ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se “*[...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...]*”.

Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin duke rishqyrtuar edhe njehere ankesën e operatorit ekonomik Nazeri 2000 shpk duke skualifikuar operatorin Flena RB dhe duke shtuar arsyet e skualifikimit për operatorin “Myrto Security” shpk në kushte kur ishte shprehur njeherë me vendim.

Sa më sipër pretendimet e ankimesve qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk lidhur me skualifikimin të ofertës së operatorëve ekonomikë “Flena RB”, “Myrto Security” shpk dhe “AEK Security” shpk me argumentin se “ *nuk ka AKEP radiokomunikim dhe alarm për qytetin e policanit sipas DST*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave per radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi qytetin e Policanit .*

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Flena RB” shpk, “Myrto Security” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Autorizim Nr.919/1 datë 23.03.2018 lëshuar nga AKEP për Flena RB shpk për sistem radiokomunikimi dhe radioalarmi me zonë mbulimi Berat Skrapar Kucovë Urë Vajgurore-40 km*
- *Autorizim nr.2115/1 datë 01.12.2017 lëshuar nga AKEP për Myrto Security shpk për sistem radiokomunikimi dhe radioalarmi me zonë mbulimi Berat Skrapar Kucovë Urë Vajgurore-40 km*
- *Autorizim Individual Nr.635/1 datë 13.02.2018 lëshuar nga AKEP për AEK Security për sistem radiokomunikimi me zonë mbulimi Berat, Corovodë, Polican, Ura Vajgurore, Kucovë-35 km.*

III.4.3. Nga verifikimet e kryera rezulton se në seksionin “Zona gjeografike e mbulimit” të autorizimit Individual lëshuar nga AKEP për operatorin ekonomik “Flena RB” shpk dhe “Myrto Security” shpk përfshin zonën e Policanit pasi distanca 40 km nga vendi bazë i instalimit mbulon vendin e kryerjes së shërbimit, objekt prokurimi. K.P.P bazuar edhe ne korenspondencën e mbajtur me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare e konkretisht shkresës nr.1971/1 prot datë 24.10.2017 në të cilën bëhet me dije se matja e zonës së mbulimit bëhet duke u nisur nga vendodhja e stacionit bazë dhe stacionit përsëritës në trajtë rrethore rreth stacionit, gjykon se me anë të dokumentacionit të dorëzuar operatorët ekonomikë Flena RB dhe Myrto Security shpk përmbushin kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për dorëzimin e *Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave per radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi qytetin e Policanit.*

Ndërsa sa i takon operatorit ekonomik AEK Security shpk KPP konstaton se është paraqitur vetëm autorizim individual për radiokomunikim dhe jo radioalarm sikundër kërkohet në kriterin e lartpërmendur të kualifikimit duke mos përmbushur kështu kriterin e kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues Nazeri 2000 shpk qëndron për operatorin ekonomik AEK Security shpk dhe nuk qëndron për operatorët ekonomikë Myrto Security shpk dhe Flena RB shpk.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Flena RB” me argumentat se “*nuk ka paraqitur 6 certifikata të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar sipas listës emërore të DVP*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.1 ” Kapaciteti ligjor” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

3. Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 6 gjashtë punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut;

III.5.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik “Flena RB” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim Nr.575/1 datë 27.02.2018 lëshuar nga DVP Berat ku jepet informacion ndër të tjera lidhur me listën emërore të punonjësve
- Certifikatë Nr.0009 datë 24.12.2015 lëshuar nga DPV Berat
- Certifikatë Nr.0124 datë 17.10.2017 lëshuar nga DVP Berat
- Certifikatë Nr.0030 datë 31.08.2016 lëshuar nga DVP Berat
- Certifikatë Nr.0107 datë 22.06.2017 lëshuar nga DVP Berat
- Certifikatë Nr.0010 datë 24.12.2015 lëshuar nga DVP Berat
- Certifikatë Nr.0104 datë 22.06.2017 lëshuar nga DVP Berat
- Certifikatë Nr.0008 datë 24.12.2015 lëshuar nga DVP Berat

III.5.3. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.5.4. Neni 5 i Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikon shprehimisht se:

1. *Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*
2. *Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut.*
3. *Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së.*
4. *Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësën e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim.*
5. *Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësën e shërbimit.*

III.5.5. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.

III.5.6. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se operatori ekonomik “Flena RB” shpk, ka dorëzuar certifikatat e punonjësve të shërbimit në përputhje me numrin e kërkuar në kriterin e kualifikimit dhe brenda afatit 4 vjeçar të parashikuar në ligj si dhe ka dorëzuar vërtetimin e lëshuar nga DVP Tiranë së bashku me listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar në të cilën pasqyrohen emrat e punonjësve të shërbimit për të cilët janë paraqitur certifikatat.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk për shtimin e arsyeve të skualifikimit për Azizolli pasi nuk përmbush detyrimet për pagë bazë , shtesa turni sigurime dhe oferta e tyre është nën koston ligjore KPP gjykon se nuk do merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi fati i operatorit ekonomik Azizolli shpk është përcaktuar që në vendimin e KVO-së të datës 11.05.2018 duke mbetur i skualifikuar në këtë procedurë prokurimi e rrjedhimisht duke përmbushur intersat e ankimuesit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e

rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesat e paraqitura nga operatori ekonomik “Myrto Security” shpk, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-64628-04-24-2018 me objekt: “Ruajtja e godinës së qendres polivalente për shërbimet e perklujdesit shoqëror Polican me roje private” – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 2.079.047.⁷⁶ lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 08.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Qendra Polivalente për Shërbime të Perklujdesit Shoqëror Polican.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Flena RB” shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk dhe “Flena RB” shpk duke i kualifikuar ata.
5. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “AEK Security” shpk duke e skualifikuar atë.
6. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Lybeshari” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
7. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
8. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Myrto Security” shpk, “Flena RB” shpk dhe “Nazeri 2000” shpk.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 993 Protokolli; Datë 24.05.2018

Nr.1039 Protokolli; Datë 01.06.2018

Nr.1102 Protokolli; Datë 13.06.2018

Nr.1013 Protokolli; Datë 29.05.2018

Nr.1090 Protokolli; Datë 12.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha